

“Krimet naziste ndaj shqiptarëve”

Diku larg, në fusha të huaja, toka të hirta e qiej të zyrtë, brenda burgjeve me tela dhe gjëmbe, valvitej lehtë një flamur i panjohur. Një e kuqe e zbehtë, mjaft e lodhur dhe gati pajetë, ledhatonte krahët e shkabës së zezë me dy krerë. Të drobitur e të copëtuar fshiheshin brenda errësirës së natës. Valviteshin së bashku me erën e përhirtë që dërgonte bashkë me ta zërat e fundit në tokën e tyre, që dikur e thërrisnin Shqipëri.

Fytyra të hequr dhe të ashpra nga dhimbjet, duar të vrazhda, të nxira e të gjakosura, krahë të lodhur e supe të kërrusur. Në barakat e tejmbushura lehtaz dëgjohej një kollë e thatë dhe rënkime të mbytura. Një qetësi gënjeshtare, që mbulonte të vdekur që merrnin frymë, shiheshin sy më sy dhe flisnin pa bërë fjalë. Racionet e pakta dhe puna e rënduar i kishte ngrënë pak nga pak format e tyre të dikurshme. Dukej se megjulla e rëndë i fshihnte dhe i mbronte nga tmerrri që ndodhej jashtë. Ishin të huaj në këtë vend si çdokush. Të huaj dhe të padëshiruar, të tmerruar dhe të dhunuar, të urreyer e të përbuzur dhe përveç të gjithave, të pafajshëm. Këto jetë të varfra vazhdonin të flinin në barakat e Mauthausen-it.

Rrallë herë mund të kujtohej ndokush për emrat e tyre të vjetër. Ato kishin mbetur mbi rrugët e kalldrëmta të atdheut të tyre, në shtëpitë e vjetra, në çetat partizane dhe në mendjet e nënave. Secili prej tyre ishte një numër, një numër i cili zbriste sadoherë ia kishte qejfi një oficeri. Thjesht numra, jo njerëz. E kush kishte nevojë t'ua kujtonte? Ishin kthyer në numra para se të mbërrinin në kamp, në vagonët e errët të mbushur me njerëz nga ku dëgjohejshin vuajtjet, lutjet dhe klithmat çnjerëzore të mbuluara nga zhurma e shinave të trenit. As vetë nuk e kishin kuptuar dhe askush akoma nuk e kuptonte. Fundja, ç'kishte për t'u kuptuar? A kishin shkak vuajtjet e tyre? Pak njerëz vazhdonin të luteshin dhe shumë të tjerë iu ishin dorëzuar fatit të tyre. Nëse do të kishte një Zot, a nuk do ta ndalonte ai tmerrin që ata përjetonin çdo ditë? Çdo ditë dhe gjithçka mbetej e njëjtë. Çdo vuajtje dhe dhimbje që ata kishin shtohet me kohën, e cila dukej sikur qëndronte në vend, e palëvizur dhe e ngathët, duke ia tretur shpresën pak nga pak dhe duke ledhatuar plagët e hapura me vajtime e dhimbje. Dhimbje, vetëm këtë njihnin zemrat e tyre, qëkur u shkëputën me forcë nga atdheu, nga shtëpia, nga liria dhe iu drejtuan në marshim vdekjes.

Tym i zi ngrihej në qiellin e errët, që nuk ishte hapur që ditën e parë që kishin ardhur dhe shpërndahej mbi fushat e blerta. Këto varreza të çelura do të mbanin brenda tyre shpirtrat e mijëra njerëzve. Hirë i zi binte si flokë dëbore dhe zhdukej kur prekte tokën. Dera e barakës kërciste nga era dimërore dhe ndriçohej nga dritat e prozhektorëve. Teshat e holla që kishin në trup dukeshin si fije kashte përpara dimrit të acartë dhe duart e tyre dridheshin pas mëngëve të grisura. Ngroheshin pas njëri-tjetrit, pas shpresës, pas kujtimeve, pas lutjeve, pas fjalëve të folura shqip dhe mjaft e qetësonte mendjen e tyre shqipja e ëmbël që i çonte larg në peisazhet e blerta të Shqipërisë.

Në sytë e të mbijetuarve, tek fytyrat e reja që ishin rrëzuar në fillin e hollë mes vdekjes dhe jetës dhe shtrëngoheshin fort pas tij. Brenda fjalëve, historive dhe shkrimeve të tyre do të gjenden copëza të këputura nga pamjet bardhë e zi të së shkuarës. Për Shqipërinë, për tokën e tyre, për forcën që ajo i kishte dhënë duhet të luftonin. Duhet të luftonin për veten e tyre, për ata që kishin vdekur, për kujtimet e tyre, sytë e tyre shpresëdhënës dhe plot jetë që ishin shuar si flaka e qiririt. Do të luftonin për gjërat e bukura që iu falte jeta, për dhimbjen, për lumturinë, për dashurinë, për dorën e ëmbël të nënës mbi kokë dhe fjalën e parë të fëmijës në djep. Do të luftonin, sepse ishin shqiptarë. Sepse, nën thundrat e Perandrosë gjysmëdhënë kurrë nuk u dorëzuan dhe para kryqit të thyer gjerman nuk kishte si të mos luftonin. Sepse brenda në venat e tyre buronte një gjak i pastër si Drini i Bardhë dhe po aq i stuhishëm si Joni me dallgë.

Dera kërciste ngadalë dhe hera-herës zëra të shqetësuar bënë melodi rrënqethëse nën errësirë. Dielli sapo kishte dalë dhe rrezet e tij depërtonin nga të çarat në barakë. Një zë çjerrës çau gjithë qetësinë e tyre të brishtë. Por, nuk ishte gjerman, as polak dhe as rusisht, për çudi diku atje tej flitej anglisht...

Punoi: Alketa Çipi

Klasa: XI

Shkolla "Drita e dijes", Berat, Shqipëri